



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 65

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Prishtinë, më 13 mars 2013, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Gëzim Kelmendi dhe Salihe Mustafa.

Munguan: Sasha Gjokiq, Liburn Aliu dhe Flora Brovina.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj– administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i lartë i fushës për shëndetësi; Xheneta Sopjani-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.03.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave, para miratimit në parim;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Me propozimin e deputetit Gëzim Kelmendi, pika e katërt e rendit të ditës u shqyrtua para pikës së tretë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.3.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës 06.3.2013.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Fikrim Damka- Tha se Komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj. Ne sot do t'i votojmë amendamentet e propozuara.

Gëzim Kelmendi- Në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, tha se grupi punues i ka hartuar këto amendamente, të cilat ju ftoj që t'i votoni.

Komisioni miratoi njëzëri amendamentet e propozuara për Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, si vijon:

Amendamenti 1

Në nenin 3, paragrafi 1.7. riformulohet si vijon:

1.7. “Pensioni i parakohshëm” - nënkupton pensionin e rregullt mujor të paguar për të punësuarit e kompleksit “Trepça”, dhe të punësuarit në minierat e tjera të Kosovës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj.

Amendamenti 2

Në nenin 6, fshihet fjala „ do të garantoj “ dhe zëvendësohet me „ garanton” .

Amendamenti 3

Në nenin 7, paragrafi 2.2. fshihet fjala „ se banon “ dhe zëvendësohet me „ është banor i përhershëm”.

Amendamenti 4

Në nenin 8, paragrafin 1, pas fjalës „ person” shtohet fjalia „ të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe “.

Amendamenti 5

Në nenin 8, paragrafi 2, në fund të paragrafit, pas fjalës „nxjerr” shtohet fjalia „ brenda 1 (një) viti “

Amendamenti 6

Në nenin 8, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri si vijon:

E drejta dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontributpagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna, ose të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore, në vitet 1989 -1999, do të rregullohet me akt ligjor ose nënligjor të veçantë, deri në fund të vitit 2014.

Amendamenti 7

Në nenin 9, paragrafi 5.1. fshihen fjalët „ për një apo më shumë vjet “.

Amendamenti 8

Në nenin 9, paragrafi 6, pas fjalës „ zyrtarët” shtohet fjalia „ përgjegjës” dhe fshihen fjalët „ aftësisë së kufizuar “ dhe zëvendësohet me „ paaftësisë së përhershme”.

Amendamenti 9

Në nenin 10, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Të drejtën për pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë të punësuarit në kompleksin “Trepça” dhe në minierat e tjera të Kosovës, të cilët kanë humbur vendin e punë.

Amendamenti 10

Në nenin 10, paragrafi 2, pjesa e parë riformulohet si vijon:

2. Pensionet e parakohshme do t’ju paguhen të gjithë të punësuarve të kompleksit “Trepça” dhe punëtorëve të tjerë të punësuar në minierat e Kosovës, nëse:

Amendamenti 11

Në nenin 10, paragrafin 2.4. fshihet fjalia „ në miniera “.

Amendamenti 12

Në nenin 10, paragrafi 2.7. fshihet fjalia „ aftësia e punës të jetë zvogëluar së paku për 50%” dhe zëvendësohet me „shkalla e invaliditetit të jetë mbi 50%”.

Amendamenti 13

Në nenin 12 , paragrafi 4.1 fshihet fjalia „ prej moshës 55 vjeçare’’ dhe në paragrafin 4.2. fshihet fjalia,, 55 deri në’’.

Amendamenti 14

Në nenin 12, paragrafi 6 , fshihen fjalët „ një apo më shumë ’’ dhe shtohet fjala „ secilin ‘’.

Amendamenti 15

Në nenin 12, paragrafin 7, fshihet fjala „ prej 70% ‘’ dhe në fund të paragrafit shtohet fjalia „ dhe duke përfshirë rritjen prej 20% sipas paragrafit 6 të këtij neni’’.

Amendamenti 16

Në nenin 13, fshihet fjala,, lartësinë ‘’ dhe zëvendësohet me „ rritjen’’.

Amendamenti 17

Neni 15, të fshihet.

Amendamenti 18

Neni 16, të fshihet.

Amendamenti 19

Neni 22, të riformulohet si vijon:

1. Pagesat e pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar të përcaktuara me këtë ligj, do të ndërpriten, si në rastet e mëposhtme:

1.1. Në rast të vdekjes së pensionistit, pagesa e pensionit ndërpritet në muajin pasues pas vdekjes së tij/saj;

1.2. Në rast se përfituesi i pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar, fiton nënshetësinë e shtetit, me të cilin Republika e Kosovës, nuk ka Marrëveshje Bilaterale për sigurime sociale;

1.3. Nëse vlerësohet se parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim ose keqinterpretim gjatë procesit të aplikimit, ose gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të ministrisë, konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit.

2. Pagesa e pensioneve për shfrytëzuesit e pensioneve kontributpaguese të përcaktuara me këtë ligj, do të ndërpriten si në rastet e mëposhtme:

2.1. Në rast të vdekjes së pensionistit, pagesa e pensionit ndërpritet në muajin pasues pas vdekjes së tij/saj;

2.2. Nëse vlerësohet se parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim ose keqinterpretim gjatë procesit të aplikimit, ose gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të ministrisë, konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit.

Amendamenti 20

Në nenin 23, paragrafi 2, në fund të paragrafit shtohet fjalia „apo kujdestarit ligjor “.

Amendamenti 21

Në nenin 25, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri 5, si vijon:

5. Me rastin e vdekjes së pensionistit, familja përfiton 3(tri) pensione, me kusht që vdekjen e pensionistit ta lajmërojnë brenda 30 (tridhjetë)ditësh nga dita e vdekjes së pensionistit.

Amendamenti 22

Në nenin 31, fshihet „01.01.2016’’ dhe zëvendësohet me „01.01.2014 ‘.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave, para miratimit në parim

Time Kadriaj- Tha se sot e kemi për miratim këtë projektligj. Unë pajtohem që të kalojë ky projektligj në parim dhe mëpastaj ta amendamentojmë.

Gëzim Kelmendi- Tha se ky projektligj paraqet bazën e sistemit për transplantimin e indeve dhe qelizave. Duhet ta përkrahim në parim miratimin e tij.

Salihe Mustafa- Tha se duhet ta miratojmë në parim këtë projektligj.

Nazane Breca- Tha se duhet ta miratojmë këtë projektligj, ndërkaq mangësitë eventuale do t'i rregullojmë gjatë punës në Komision.

Bahri Thaqi- Tha se duhet ta miratojmë në parim këtë projektligj.

5. Të ndryshme

Time Kadriaj- Tha se sot duhet ta shqyrtojmë një letër që ka ardhur nga punëtorët e Inspektoratit shëndetësor. Inspektorati është mekanizëm i rëndësishëm dhe është një mekanizëm që e mban shëndetësinë. Ministri është ai që duhet të merret me çështjet e Inspektoratit. Unë shpesh i kam ngritur këto çështje, por ministri u ka ikur këtyre çështjeve. Kryeinspektorja nuk mund të jetë edhe specializante në të njëjtën kohë, pra t'i ketë dy kontrata punë. Është shkelje ligjore, për të cilën ministri duhet të përgjigjet. Unë ndiej obligim, sepse kam qenë zv. kryeinspektore dhe një kohë edhe U.D kryeinspektore.

Nazane Breca- Tha se çështja është e rëndësishme dhe duhet të diskutojmë me ministrin. Duhet ta shqyrtojmë si pikë të parë me ministrin, por pa përjashtuar edhe çështjet e tjera.

Salihe Mustafa- Tha se këto janë probleme të brendshme të stafit të Inspektoratit. Por, megjithatë duhet ta pyesim ministrin për këtë dhe çështjet e tjera.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që ta ftojë në takim ministrin e Shëndetësisë, për të diskutuar për çështjen e ngritur, por edhe për çështje të tjera nga fusha e shëndetësisë.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka